



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr. 02/ *264*
Datë: 23.04.2019

Procesverbal
i mbledhjes se I (*urgjente*) për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/185 datë:22.03.2019, për miratim të projekt-Planit Zhvillimor Komunal 2019-2027 të Komunës së Malishevës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/209 të parashtruar nga Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme Komunale.
3. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 04.04.2019, filloj në ora 10, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, përfaqësuesi i Osbe, zyra për informim.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve kemi thirr mbledhje urgjente dje që u morëm vesh për sot, janë edhe disa kërkesa për ndërrim destinim dhe një kërkesa të Komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës publike për vendosjen e billbordeve.

Alban Krasniqi: Nëse vazhdojnë kështu me na ardhur kërkesat unë do t'i kundërshtoj që mos të bëhen precedentë për vendimmarrje, e që përveç PZHK-së asnjë kërkesë tjetër nuk është urgjente. Nëse i fusim edhe pikat tjera atëherë i humbu qëllimi i thirrjes së mbledhjes urgjente i humbi sensi dhe krijohen precedentë. Anën tjetër asnjë pikë për ndërrim destinim pa debat se kaloj, sikur që dje e kemi pas dorëheqjen e Verës në Kuvend nga Komiteti për Barazi gjinore ama jo edhe zëvendësimin e ju qohi bëni pazare, kjo s'është serioze kështu pra dallimet tona këtu s'bën të shprehen kur janë qëllimet e drejta. Anashkalimet dhe futjet jashtë kësaj që flasim e dëmtojnë procesin, plus marrëveshja me BIK-un s'është futur. Për ndërrim destinimin tash kemi edhe rregulloren e që po shihet se veç a shtuar volumi i fjalëve, barrën e procedurës duhet me pas të sigurt që drejtoritë ta kryejnë punën. Pikat të shqyrtohen radhazi po ashtu edhe vendimmarrja.

Raimonda Krasniqi: Për sqarim për opinionin në kemi përkrahë komitetin për barazi gjinore për të dhënë kontributin e tij, bile shpesh kam qenë edhe pjesëmarrëse për të kontribuar për të drejtat e grave, përzgjedhja e Isuf Morinës në vend të Vera Bytyqit në atë komitet ska pas tendencë e as qëllim të jashtëligjshëm.

Rahim Morina: Çka po fusim në mbledhje se i kam disa pika dje që na kanë mbete.

Raimonda Krasniqi: Sidomos pika e Arsimit të futet sepse drejtorët po na neglizhojnë.

Hashim Vrenezi: Më e rëndësishmja është marrëveshja me BIK se ka mbet pezull.

Rahim Morina: Çështja me BIK ka mbete me trajtuar edhe një herë përmes KPF-së dhe kryetari.

Hashim Vrenezi: Të shtesa për 30 euro që tani është rritur për shpenzimet e varrimit problemi ka qenë edhe më herët.

Alban Krasniqi: Kjo trajtohet më një shkresë ose në marrëveshje më BIK-un.

Hashim Vrenezi: Për PZHK veç shefave tjerët materialet si kemi pas.

Rahim Morina: Tash me material ju sjellim edhe CD, sepse materiali ka qenë voluminoz.

Kush jeni për këtë rend të ditës me disa pika që na kanë mbete nga mbledhja dje që kemi mbajtur.

Unanimisht ishin për rendin e ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/185 datë:22.03.2019, për miratim të projekt-Planit Zhvillimor Komunal 2019-2027 të Komunës së Malishevës.

Alban Krasniqi: Vendimmarrja a ka qenë sipas PZHK apo ad-hoc qysh janë kryer edhe punët.

Nëse në një pjesë që ka qenë i parapare mu ba gjelbërim e nëse sju jeni përmbajtur a ka shkelje ligjore, gjendja e PZHK deri tash cili ka qenë statusi juridik dhe cili është tash. Shpjegimi duhet me qenë Professional dhe përmes Paver point dhe me slajde, cila është baza ligjore që ka ndaluar deri tash.

Hashim Vrenezi: Deri sa është miratuar në Kuvend, se besoj që tani me miratuar prodhon ndonjë efekt juridik pra ku është efekti i atij të mëhershmit.

Muharrem Morina: PZHK hartohet prej Komunës edhe unë kam qenë pjesë e atij grupit punues, pastaj ka dal ne debat publik se edhe shumë dokumente kur miratohet si PZHK duhet të jenë në përputhje me të sikur KAB e tjera. PZHK pas miratimit shkon në Ministri, por deri tani Ministrinë e kanë stopuar e tani e kanë certifikuar dhe kanë kërkuar të miratohet dhe kërkohet vendim përfundimtar.

Alban Krasniqi: Mua me intereson baza ligjore a është zbatuar Plani Zhvillimor në tërë territorin e Komunës së Malishevës të bazuar në Ligj, kërkojmë sqarime lidhur me ndryshimet e Planit Zhvillimor Komunal paraprak dhe projekt Planit Zhvillimor të tanishëm i cili është paraqitur për miratim.

Rahim Morina: Kush jeni të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/209 të parashtruar nga Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme Komunale.

Muharrem Morina: Çështja është se vendimi kur a miratuar ka pas defekte, sepse unë edhe ne mbledhje të komisionit ju kam sqaruar se ne nuk vendosim se si vendosen billbordet por duhet të vendosim për tokën ku janë të vendosur. Të specifikohet se toka jepet në shfrytëzim.

Hashim Vrenezi: Logjikisht se ka pas neglizhencë të procesit dhe njerëzit që i kanë shfrytëzuar ato hapësira s'kanë paguar deri tani. Edhe rastin e kemi në bazenin në Banjë po e japim në shfrytëzim e jo tokën aty. Duhet me pas informacion kush është aj që ka pas këto billborde në shfrytëzim, a kanë mirë Komuna mi vendosë ato billborde e ata veç me kryer pagesën, e ato që janë kanë të vendosura deri tani mi hjekë, dhe me kërkuar sqarime të kujt janë ato.

Rahim Morina: Ne mund të kërkojmë nga Kryetari me ditë deri tash të kujt janë kanë billbordet, kush i ka shfrytëzuar, sa kërkohet hapësirë mi vendosur reklamat.

Alban Krasniqi: Praktika e Komunës së Prishtinës e ka pas këtë dhe ka përdorur monopol për kompanitë që ka vendosur billbordet. E tash i paskan hjekë se kompanitë si kanë kryer obligimet dhe ja ka konfiskuar. Komisioni me këqyr, e bazën ligjore e diskutojmë edhe në Kuvend.

Dihet se billbordet janë të kompanisë së djalit të Fatmir Limajt, kompania Orange e që Komuna qëllimisht po e neglizhon e anën tjetër vazhdon vendosja e billbordëve. Veç leja duhet mu vendos e çmimi caktohet për metër katror naltë, ajo kompani që i ka pas a i ka kryer obligimet deri tash, nëse jo a ka të drejtë Komuna mi konfiskuar duhet ti dijmë ne këto në Kuvend.

Rahim Morina: Kush jeni qe ta rekomandojmë për Kuvend këtë kërkesë?

Unanimisht ishin për.

Rahim Morina: Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 11:30 min.

Procesmbajtësi
Naim Avdijaj jur. i dip


